



01/Nr. 281/2020

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 Neni 11 , 12 paragrafi 12.2 shkronja (d), 40, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit, 01 nr.7703/2018 të datës 25.10.2018 neni 24 , paragrafi 24.5, shkronja (c) , Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 30. 01. 2020 merr:

**VENDIM
PER NDARIEN E MJETEVE**

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për ndarjen e mjeteve financiare, si ndihmë për zonat e dëmtuara nga tërmeti ne Republikën e Shqipërisë.
2. Shuma e mjeteve financiare të ndara, sipas pikës (1) të këtij vendimi, është 10,000.00 € (dhjetë mijë euro) dhe merren nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga zyra e Kryetarit të Komunës, kodi buxhetor 16035.
3. Qëllimi i këtij vendimi është dhënia e ndihmës, të cilën Komuna e Hanit të Elezit ia ndan Shqipërisë për sanimin e dëmeve të shkaktuara në zonat e dëmtuara nga tërmeti.
4. Mjetet e cekura sipas pikës (2) të këtij vendimi, do të derdhen në xhirollogarinë e hapur të Republikës së Shqipërisë për këtë fatkeqësi natyrore posa të alokohen gjatë vitit 2020 nga buxheti i komunës.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave.
6. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 30.01.2020

Kryesuesi i Kuvendit
MSc. Qamush-Brava





01/Nr. 291/2020

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 Neni 11 , 40, Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal numër Nr.03/L-049 Neni 2, dhe në bazë të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me numër Nr. 01/ 4805/ 2018 të datës 30.08.2018, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 30. 01. 2020 merr:

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR BURSA PËR STUDENTËT E KOMUNËS SË
HANIT TË ELEZIT

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për ndarjen e mjeteve financiare për bursa për studentët në Komunën e Hanit të Elezit për vitin akademik 2019/2020.
2. Mjetet financiare të cilat do të dedikohen për ndarjen e bursave për studentë merren nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere vlera e të cilave është në shumë prej 15,000.00 €, që do të përfitojnë 30 (tridhjetë) studentë për dhjetë muaj nga 50.00 € në muaj.
3. Prioritetet për kuadro deficitare janë në Fakultetet:
Fakulteti i Mjekësisë (Mjekësi e Përgjithshme, stomatologji).
Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës (Ndërtimtari dhe i Arkitekturës).
Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (Inxhinieri Kompjuterike, Telekomunikacion, Elektronikë, Automatikë, Sistemet Elektroenergjetike, Elektroenergjetikë Industriale).
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike (Prodhimtari dhe Automatizim, Termoenergjetikë dhe termoteknikë, Konstruksione dhe mekanizim, Komunikacion).
Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë (Agroekonomi, Bioteknologji në Zootekni, Lavërtari – Perimtari, Mbrojte e Bimëve, Pemëtarë – Vreshtari, Veterinari, Bioteknologji Ushqimore).
Fakulteti i Xehetarisë dhe Metalurgjisë (Xehetarisë, Gjeologjisë, Materiale dhe Metalurgji, Teknologjisë).
Fakulteti i Shkencave Matematikë – Natyrore (Matematikë Fizikë Kimi).
Fakulteti Arteve
Fakulteti Filologjik (Gjuha Angleze, Gjuha Gjermane).

4. Bursat ndahen për studentët e vitit të dytë e lartë. Në rast të mos plotësimit të bursave nga viti i dytë e lartë, plotësohet sipas rregullores për ndarjen e bursave edhe për vitin e parë të studimeve.
Përzgjedhjen e kandidatëve do ta bëjë komisioni i formuar nga drejtoria për arsim, kulturë, rini dhe sport sipas rregullores për ndarje të subvencioneve.
5. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 30.01.2020

Kryesuesi i Kuvendit
MSc. Qamush Brava





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 283/2020

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, neni 11, 40, Rregulloren për Organizimin, Funkionimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në Territorin e Komunës së Hanit të Elezit numër 01/Nr.9274/2019, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 30. 01. 2020 merr:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KËSHILLAVE TË FSHATRAVE TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2020

1. Kuvendi i Komunës miratoi vendimin për planin e punës së këshillave të fshatrave të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2020.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është plani i punës së këshillave të fshatrave të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2020.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendimi njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtoria e Administratës,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 30.01.2020

Kryesuesi i Kuvendit
MSc. Qamush Brava





01/Nr. 656/2020

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11 , 40, Ligjin për Arsimin në komunat e Republikës së Kosovës neni 5 paragrafi (d), Udhëzimin Administrativ nr.15/2019 për Detyrat, Përgjegjësitë Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorit të Institucionit Publik Edukativo Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar, neni 5 paragrafi (1) nënparagrafi (1.1) , Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 30. 01. 2020 merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËRZGJEDHËS

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për formimin e komisionit përzgjedhës për drejtor të Shkollës Filllore të Mesme të Ulët "Ilaz Thaçi" në Han të Elezit.
2. Duke iu referuar nenit (1) të këtij vendimi, komisioni do të ketë këtë përbërje:
 - Sear Dërnjani, (nga DKA) kryesues i komisionit,
 - Vlora Suma, (nga këshilli i prindërve), anëtare dhe
 - Sahit Berisha (nga MASHT-i) anëtar.
3. Komisioni përzgjedhës do të veproj sipas udhëzimeve të parashikuara në Udhëzimin Administrativ nr.15/2019 për detyrat, përgjegjësitë procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të institucionit publik edukativo arsimor dhe aftësues parauniversitar.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Anëtarët e komisionit
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 30.01.2020

Kryesuesi i Kuvendit
MSc. Qamush Brava





01/ Nr. 184/2020

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Udhëzimin Administrativ Nr.01/2016 për Procedurat e Themelimit , Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, neni 11 pika 3, Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës së Hanit të Elezit neni 55, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.01.2020 merr:

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS PËR TRI KOMITETET KONSULTATIVE PËR
VITIN 2020

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për planin e punës për tri komitetet konsultative të Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2020.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është plani i punës për vitin 2020 për mbledhjet që do të mbahen për komitetin konsultativ për Zhvillim Ekonomik, Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Ambientit, për komitetin konsultativ për Arsim, Kulturë, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, për komitetin konsultativ për Shërbime Publike dhe Emergjencë.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Komitete Konsultative
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 30. 02. 2020

Kryesuesi i Kuvendit
MSc. Qamush Brava





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 282/2020

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës neni 55, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.01.2020 merr:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2020

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për planin e punës së Komitetit për Komunitet për vitin 2020.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është plani i punës së Komitetit për Komunitet për vitin 2020.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendimi njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Anëtarët e Komiteti për Komunitete,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 30. 01. 2020

Kryesuesi i Kuvendit
MSc. Qamush Brava

